



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-253
15.8.2023
Shkup

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, Vendimin PA1 nr.08-253 datë 3.8.2023, për marrje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-3115/5 datë 15.8.2023, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 26-të mbajtur më 14.8.2023 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore, me marrjen e lejes nga Agjencia. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar në Ligj, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka ndaluar së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 25-të mbajtur më 1.8.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2966/2 datë 1.8.2023, miratoi Vendim PA1 nr.08-253 datë 3.8.2023 me të cilën i mirret leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) televizionit IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, për shkak se poseduesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera, që paraqet bazë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe në pajtim me nenin 10,

paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastuar), Vendimin PA1 nr.08-253 datë 3.8.2023, për marrje të lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015 dhe konkluzionin me nr.ark.02-3115/5 datë 15.8.2023, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 26-të mbajtur më 14.8.2023, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.